



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:128528

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06654701

E.Rev.nr.66/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit - propozuesit të sigurimit: “R.” Sh.p.k., me NUI ..., me seli në S., të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “V. &L.”, me avokat Florin Lata, avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurit - kundërshtarit të sigurimit: “R.” Sh.p.k., me NUI ..., me seli në P., të cilin e përfaqëson Taulant Hodaj avokat në P., sipas autorizimit, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit - kundërshtarit të sigurimit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1686/24, të datës 25.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË i palejuar revizioni i të paditurit - kundërshtarit të sigurimit: “R.” Sh.p.k., me NUI ..., me seli në P., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1686/24, të datës 25.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, KP.nr.20/24 të datës 15.08.2023, është vendosur: Aprovohet si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit “R.” Sh.p.k., ndaj kundërshtarit të sigurimit “R.” Sh.p.k., zëvendësohet masa e përkohshme e sigurimit e caktuar sipas aktvendimit KP.nr. 20/24 të datës 05.07.2024, Caktohet masa e sigurisë dhe i ndalohet kundërshtarit të masës “R.” Sh.p.k., që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë, apo disponojë, me njësitë ndërtimore: Nr. Njesisë ..., Kati ..., Lokal, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqem²; Nr. Njesisë ..., Kati ... Banesë, në sipërfaqe.

...m²; Nr. Njesisë ... Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m² Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m²; Nr. Njesisë ..., Kati ..., Banesë, në sipërfaqe. ...m². Obligohet Zyra Kadastrale e Prizrenit dhe Oda e noterëve të Kosovës, për zbatimin e vendimit dhe ndalimin nga paragrafi II të këtij dispozitiv ta regjistrojnë në regjistrat përkatës.

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1686/24 të datës 25.09.2024, është vendosur: I. Refuzohet si e pabazuara ankesa e kundërshtarit të masës së sigurimit "R." Sh.p.k., me NUI ..., me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Taulant Hodaj me seli në P. . II. Vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KP.nr.20/24 të datës 15.08.2023.

Kundër këtij aktvendimi kundërpropozuesi i sigurimit në afat ligjor, ka paraqit revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni i kundërpropozueses dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë -Departamenti për Çështje Ekonomike dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Revizioni është i palejueshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësit - propozuesit e sigurimit në gjykatën e shkallës së parë më datë 03.05.2024, kanë paraqitur padi, për përmbushjen e kontratës dhe kompensimin e dëmit, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, me saktësisht të përshkruar si në padi dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditësve - propozuesve të sigurimit, për caktimin e masës së sigurisë, ka marr aktvendimin KP.nr.20/24 të datës 15.08.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimi i paditëses - propozueses së sigurimit, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kundërpropozuesi i sigurimit ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj K.DH.SH.II.nr.1686/24, të datës 25.09.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e kundërpropozuesit të sigurimit, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, kundërpropozuesi i sigurimit ka paraqitur revizion, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërisë e revizionit dhe konstatoi se në këtë rast revizioni është i palejueshëm, për arsye se:

Me nenin 218, të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: " 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni

është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet ”.

Me nenin 228 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet së: “ Palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallë së dytë ”, ndërsa në paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se: “ Nuk lejohet revizioni kundër aktvendimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në konteste në të cilat nuk do të ishte i lejuar revizioni ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1686/24, të datës 25.09.2024, pasi kemi të bëjmë me aktvendim me të cilin është vendosur për aprovimin e masës së sigurisë, e jo me aktvendim të formës së prerë, me të cilin përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë meritore dhe se ky lloj i aktvendimit nuk është vendim përfundimtar, që do me thënë se është aktvendim me karakter të përkohshëm, dhe se me pushimin apo ndryshimin e rrethanave për të cilat është vendosur i njëjti mund të ndryshohet.

Më qenë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh revizionin e kundërpropozuesit të sigurimit ashtu siç përcaktohet me nenin 218 të LK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës sipas neni 221 e lidhur me nenin 230 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të neni 221 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr. 66/24, më datë 23.12.2024.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi